



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

09.Nr. 299/ 2012

Data:19.04.2012

Në mbështetje të nenit 101.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor Nr.02/L-70 të dt: 11 janar 2007, nenit 8.1 të Udhëzimit Administrativ N6.02/2009-PK dt: 21.07.2009, të nenit 38 të Statutit të Komunës së Gjiçanit dhe të nenit 1 dhe 3 të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.01.10041/020 të datës 23.10.2003, për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve (veturave), Drejtoria për Shërbime Publike shpallë:

ANKAND PUBLIK për shitjen e automjeteve

- I. Në këtë ankand shiten 54 mjete motorike të konfiskuara nga policia.
- II. Mjetet janë të vendosura në auto-parkingun e Komunës, i cili gjendet në anën e majtë të rrugës qarkore, që shpie nga Fabrika e Baterive për në rrugë të Prishtinës- afër seperacionit „Gllama”. Ato mund të vizitohen me datën: **26 prill 2012(e Enjëte)**, nga ora **10:00** deri në ora **15:00**.
- III. Automjetet janë pa dokumente përkatëse, të vjetruara dhe mjaft të demoluara. Të gjitha automjetet shiten si një tërësi (komplet-pa u ndarë)
- IV. Çmimi fillestar i të gjitha automjeteve është **7.670.00€** (shtatë mijë e gjashtëqindë e shtatëdhjetë euro).
- V. Të drejtë pjesëmarrje në ankandin publik, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik, duke paguar pjesën garantuese për pjesëmarrje në ankand në vlerë prej **10%** të çmimit fillestar të ankandit.
- VI. Fituesit të ankandit mjetet garantuese të deponuara do t'i llogariten në shumën e përgjithshme të vlerës së mallit të blerë, ndërsa të tjerëve këto mjete do t'u kthehen.
- VII. Aplikacionet për ankand dorëzohen në Drejtorinë për Shërbime Publike prej **19 prill 2012** deri më **03 maj 2012**, nga ora **8:00** deri në ora **15:00**.
- VIII. Ankandi publik do të mbahet në lokalet e Drejtorisë, me datën **03 maj 2012** (e Enjëte) duke filluar prej orës **15:15**.
- IX. Ankandi publik, mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën e përditshme Epoka e Re.
- X. Me fituesin e ankandit do të lidhet kontrata për automjetet e blera.
- XI. Nëse fituesi i ankandit tërhiqet nga blerja, atëherë mjetet garantuese të deponuara nuk do t'i kthehen.
- XII. Detajet tjera, për çdo automjet janë të paraqitura në tabelat për shpallje të Komunës..

Drejtori

Behar Mehmeti